

Qendra Për Arsim Cilësor
KËRKESË PËR INFORMACION

Pyetje 1. Sa është numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të spektrit autizëm, të regjistruar pranë Bashkisë Tiranë

Përgjigje:

Numri i përgjithshëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara të spektrit autizëm te grupmoshës 0-18 vjeç të regjistruar në Njësitë Administrative 1-24 dhe Lagjet 12, 13, 14 është: **Gjithsej 633 fëmijë me CSA.**

Pyetje 2: Cila është lista e të gjitha shërbimeve të kujdesit social të integruar nëpërmjet Skemave të Programit të Mbrojtjes Sociale, që ofron konkretisht bashkia e këtij qyteti në kuadër të kujdesit social për fëmijët me aftësi të kufizuara

Përgjigje:

Shërbimet e integruara për këtë grup në nevojë jnaë:

1. Përfitim i ndihmës ekonomike për personat me aftësi të kufizuara të paaftë për punë, me aftësi fizike, aftësi mendore dhe shqisore (KMCAP)
2. Shërbim mjekësor ambulator falas në banesë nga mjeku i familjes dhe ai specialist (në rast nevojë)
3. Zbatimi politikave të rejasi ai i skemës së konvertimit nga pagesa cash në shërbime shoqërore për personat me aftësi të kufizuara
4. Rritja e cilësisës së shërbimit psikoterapeutik për personat me aftësi të kufizuara dhe kapaciteteve profesionale përmes trajnimit profesional te specializuar sipas standardeve të OBSH-së
5. Zbatimi i projekteve në bashkëpunim me Organizata të Shoqërisë Civile, me qëllim vendosjen e nje sistemi efikas të identifikimit dhe zbatimit të programit të ndërhyrjes së hershme për fëmijët me AK.
6. Asistencë per PAK në situatë rrugë
7. Mundësimi i përshtatshëm të arsyetuar në infrastrukturën rrugore dhe atë të institucioneve publike lidhur me aksesibilitetin fizik të PAK.
8. Sigurimi i aksesibilitetit ne informacion dhe pjesëmarrje në vendimmarrje për PAK.
9. Bashkëpunim ndërinstitutional në hartimin e politikave dhe përmirësimit të kuadrit ligjor ne fushen e AK.

Shërbimet operacionale ofruar në qendrat sociale multidisiplinare bashkiake janë:

1. Identifikim, vlerësim, informim dhe këshillim psiko-mediko-social për personat me AK;
2. Seanca edukativo – mësimore
3. Shërbimi i fizioterapisë
4. Shërbimi i logopedisë
5. Terapi zhvillimi individuale dhe në grup
6. Këshillim mjekësor dhe referim për trajtim te specializuar, sipas rastit
7. Aktivitete argëtuese / kulturore/informuese për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara
8. Trajnime, takime informim me prindër dhe anëtarë të komunitetit për rritjen e kapacitetit të tyre në mbeshtetje të problemeve me femijët e të rinjtë me AK.
9. Takime individuale me prindërit dhe kujdestarët e tyre për këshillim në zgjidhjen e problemeve që ata kanë më institucionet e tjera, asistencë për përfitim të KAMCP, pajisje ndihmëse, si dhe për integrimin në sistemin e mbrojtjes sociale, arsimor dhe shëndetësor i fëmijëve e të rinjve me probleme sociale dhe të zhvillimi
10. Vizita në familje
11. Advokaci dhe Lobim
12. Shërbimi I mencës dhe i ushqimit catering
13. Referim dhe menaxhim rasti, trajtim djhe monitorim i ecurise se tij
14. Shërbimi i transportit për personat me aftësi të kufizuara

Pyetje 3: Cilat janë qendrat që i ofrojnë këto shërbime të specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe si financohen ato

Përgjigje:

Bashkia Tiranë, në ushtrimin e detyrës së saj funksionale, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 121/2016, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, si dhe në zbatim të kuadrit ligjor për të drejtën e personave me AK, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të kufizuara, ka në strukturën e saj të vartësi (katër) qendra sociale multidisiplinare, (si më poshtë), që ofrojnë shërbim të specializuar edhe për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara (PAK), të cilat 3 prej tyre *funksionojnë nga e hëna – të premte, në orarin 8:00 – 16:00*, ndërsa Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhi” *funksionon nga e hëna – të premte, në orarin 8:00 – 20:00*.

1. Qendra Sociale Multidisiplinare:

Adresa: Rruga. Maliq Muca, Njësia Administrative nr. 9;

2. Qendra Komunitare Shkozë

Adresa: Blloku i Banesave Sociale Shkozë, Njësia Administrative nr. 1;

3. Qendra Sociale “Të Qëndrojmë së Bashku”;

Adresa: Rruga e Kavajës, ish- Kombinati Misto Mame. Njësia Administrative nr. 6;

4. Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”

Adresa: “Selaudin Bekteshi”, pranë shkollës “Ardian Klosi

Pyetje 4: Sa është numri i fëmijëve me AK që përfitojnë shërbime nga këto qendra

Përgjigje

Qendra Sociale Multidisiplinare: Fëmije me AK që frekuentojnë qendrën janë: **gjithsej 25;**

Qendra Komunitare Shkozë: Fëmije me AK që frekuentojnë qendrën janë: **gjithsej 13;**

Qendra Sociale “Të Qëndrojmë së Bashku”: Fëmije me AK që frekuentojnë qendrën janë: **gjithsej 47;**

Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”: Fëmije me AK që frekuentojnë qendrën janë: **gjithsej 30;**

Pyetje 5: Sa është numri i personelit në këto qendra dhe cili është kualifikimi i tyre

Përgjigje:

Qendra Sociale Multidisiplinare: stafi përbëhet nga **24 punonjës**, përkatësisht: *Psikolog, Punonjës social, Fizioterapist, Logopedist, Jurist, Mësues- edukator, Operator Social/ Edukator, Financier, Ekonomiste*, si dhe staf mbështetës *Kuzhinier, Sanitare. Shofer/ mirëmbajtjes, Roje;*

Qendra Komunitare Shkozë: stafi përbëhet nga **23 punonjës**, përkatësisht: *Psikolog, Punonjës social, Mësues edukator, Operator social, Financier, Ekonomiste*, si dhe staf mbështetës, *Kuzhinier, Sanitare. Shofer/ mirëmbajtjes, Roje;*

Qendra Sociale “Të Qëndrojmë së Bashku”: stafi përbëhet nga **25 punonjës**, përkatësisht: *Psikolog, Punonjës social, Terapist Okupacional, Operator social, Edukator, Financier, Ekonomist, Jurist, Mjek* si dhe staf mbështetës, *Kuzhinier, Sanitar, Shofer/ mirëmbajtjes, Roje;*

Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”: stafi përbëhet nga **26 punonjës**, përkatësisht: *Psikologji, Punë sociale, Fizioterapi, Financë, Instruktor Arti, Instruktor Muzike, Edukator*, si dhe staf mbështetës, *Receptionistë, Kuzhinier, Sanitare, Roje, Shofer/ mirëmbajtjes*

Pyetje 6:

Përgjigje:

Qendra Sociale Multidisiplinare: Buxheti total në Lek akorduar është 29,850,726

dhe Parashikuar 2020 /Total në Lek është **29,424,000.00**

Qendra Komunitare Shkozë: Buxheti total në Lek akorduar është **28968148** dhe Parashikuar 2020 /Total në Lek është **33.923.000**

Qendra Sociale “Të Qëndrojmë së Bashku”: Buxheti total në Lek akorduar është **33.065.443** dhe Parashikuar 2020 /Total në Lek është **33.923.000**

Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”: Buxheti total në Lek akorduar është **30.159.910** dhe Parashikuar 2020 /Total në Lek është **22.350.000.**